

**RAPORT MBI  
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT  
NR. 01/2023**

20 mars 2023

## I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ të AAC-së Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren, si në vijim:

- **RREGULLORE (AAC) NR. XX/2023 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 17/2017 NË LIDHJE ME DISPOZITAT PËR OPERIME NË ÇFARËDO KUSHTE TË MOTIT DHE NË LIDHJE ME DEFINICIONIN PËR SNOWTAM**

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, paragrafi 5.2 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, nga data 21 shkurt 2023 deri më 08 mars 2023.

Neni 5, paragrafi 5.1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: “AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuara”

Konsultimi publik për rregulloren në fjalë u realizua sipas paragrafit 5.1 a) të Udhëzimit të lartcekur.

## II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes për konsultim publik të palëve të interesit i është përgjigjur LIMAK Kosovo International Airport Sh.a. më dt. 27 shkurt 2023, përmes postës elektronike zyrtare të AAC-së me komentit më poshtë (i paraqitur në origjinal si dhe përkthimin në gjuhën shqipe):

### 1) Komenti i parë:

*“ The Public Private Partnership Agreement (PPP Agreement) signed between the Republic of Kosovo and Limak Kosovo International Airport JSC (LKIA), dated 12.08.2010, accordingly defines in Clause 10 “UNDERTAKINGS OF GRANTOR” - Subclause 10.2 “OTHER GOVERNMENTAL SERVICES” the services which are under the responsibility of the Grantor (meaning all Governmental Agencies and the Government of Republic of Kosovo) regarding Pristina International Airport “Adem Jashari”. In addition, Annex I “Grantor Services” of the PPP Agreement, further states that the each of these services are under the responsibility of the Grantor.*

*However, Article (2) of the draft regulation states that “(2) In Annex III, in point ADR.OR.C.005, the following point (e) is added: ”(e) The aerodrome operator, in order to ensure the safe operation of aircraft at the aerodrome, shall provide and maintain, directly or through arrangements with third parties, visual and non-visual aids, meteorological equipment and any other equipment, commensurate with the type of operations conducted at the aerodrome.” which is in direct contradiction with the PPP Agreement. Therefore, we, as LKIA, would like to ask you*

to change this Article so that it complies with the terms of the PPP Agreement and accordingly reflects the obligations of the Grantor.”

Përkthimi:

“Marrëveshja e Partneritetit Publik Privat (Marrëveshja PPP) e nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Aeroportit Ndërkombëtar Limak Kosova Sh.A (LKIA), e datës 12.08.2010, definon në përputhje me pikën 10 “PËRGJËSHITË E DHËNIESIT” – Nën-pika 10.2 “SHËRBIME TJERA TË QEVERISË” shërbimet të cilat janë nën përgjegjësinë e dhënësit (që nënkupton Agjencitë Qeveritare dhe Qeveria e Republikës së Kosovës) lidhur me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Për më tepër, Shtojca 1 “Shërbimet e Dhënësit” e Marrëveshjes PPP, më tej thotë se secila prej këtyre shërbimeve është nën përgjegjësinë e dhënësit.

Megjithatë, Neni (2) i projekt-rregullores thotë se “(2) Në Shtojcën III, në pikën ADR.OR.C.005, është shtuar pika vijuese (e): “(e) Operatori i aerodromit, me qëllim që të sigurojë operimin e sigurt të fluturakeve në aerodrom, do të sigurojë dhe mirëmbajtje, drejtpërdrejtë ose përmes marrëveshjeve me palët e treta, ndihmesat vizuale dhe jovizuale, pajisjet meteorologjike dhe çdo pajisje tjetër, në përputhje me llojin e operimeve të zhvilluara në aerodrom”;” e cila është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Marrëveshjen PPP. Prandaj, ne, si LKIA, dëshirojmë t’ju kërkojmë ta ndryshoni këtë nen në mënyrë që ai të jetë në përputhje me kushtet e Marrëveshjes PPP dhe në përputhje me detyrimet e dhënësit.”

### **Përgjigje e AAC-së:**

Marrëveshja midis Limak Kosovo International Airport Sh.a. (LKIA) dhe Komitetit për Partneritet Publiko Privat (PPP) si dhe çdo marrëveshje tjetër mund të konsiderohet si “marrëveshje me palën e tretë”, ashtu siç përcaktohet në pikën ADR.OR.C.005 të Projekt-Rregullores në fjalë.

Prandaj, AAC konsideron që pika ADR.OR.C.005 nuk ka nevojë të ndryshohet.

### **CAA answer:**

The agreement between Limak Kosovo International Airport JSC. (LKIA) and the Committee for Public Private Partnership (PPP) as well as any other agreement may be considered as an "agreement through a third party", as stipulated in point ADR.OR.C.005 of the draft Regulation in question.

Therefore, CAA considers that point ADR.OR.C.005 does not need to be changed.

## **2) Komenti i dytë:**

AAC ka vendosur që në këtë Projekt-Rregullore, në versionin në gjuhën shqipe, për shkak të saktësisë në terminologji të ndryshoj termin nga “**çfarëdo kushte meteorologjikë**” në “**çfarëdo kushte të motit**”.

### **III. PËRFUNDIM**

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloren, është pranuar 1 vërejtje/koment me shkrim më dt. 27 shkurt 2023. AAC ka dhënë përgjigjen rreth këtij komenti dhe ka konsideruar që Projekt Rregullorja nuk ka nevojë të ndryshohet në këtë aspekt.

#### **Raporti është hartuar nga:**

- Departamenti i Aerodromeve;
- Zyra për çështje ligjore të Aviacionit.